



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 51491

Data: 21/12/2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 15.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për vitin akademik 2022/23, do të ndajë bursa për të gjithë studentët e nivelit bachelor, të cilët i plotësojnë kriteret e propozuara sipas konkursit publik.
- II. Lartësia e bursës universitare për vitin akademik 2022/23, për çdo përfitues do të jetë 660.00 € (gjashtëqind e gjashtëdhjetë euro) dhe ndahet për rezultatet e arritura gjatë vitit akademik 2021/2022. Bursa ndahet për periudhën e studimeve, përkatësisht për 10 (dhjetë) muaj të vitit akademik.
- III. Lartësia e bursës universitare si në pikën II do të rishikohet për mundësi të rritjes, varësisht numrit të përfituesve dhe disponueshmërisë së mjeteve financiare.
- IV. Për studentët që janë përfitues të bursës universitare, ndarja e mjeteve do të bëhet në vitin akademik 2022/23, nga buxheti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- V. Obligohen shërbimet financiare të njësive akademike që në bashkëpunim me shërbimin financiar të UP-së ta zbatojnë këtë vendim.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Këshillit Drejtues të UP-së,
3. Dekanëve të njësive akademike,
4. Sekretarëve të njësive akademike,
5. Shërbimeve financiare të njësive akademike,
6. Zyrës për buxhet dhe financa të UP-së,
7. Zyrës ligjore të UP-së,
8. Zyrës për shërbime të studentëve në UP,
9. Asistentes së KD-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Altin Sahiti, kryesues